

Vendim nr. 242 datë 30.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 30.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BARDHYL IBRA**

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm të dy çështjeve gjyqësore nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Konstatimi i komunikimit të dy vendimeve gjyqësore tej afateve ligjore.

Konstatimi i shkeljes së afateve ligjore të hetimit e të çështjes nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 90600-00004-00-2025, datë 12.02.2025 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 16, 18, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë

**10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i
ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka parashtruar se ka paraqitur kallëzim penal në datën 23.10.2017 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj një gjyqtari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe një prokurori të prokurorisë pranë asaj gjykate. Me pretendimin se hetimi penal ka zgjatur përtej afatit të arsyeshëm, kërkuesi, në datën 27.03.2018, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afateve ligjore të hetimit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe përshejtimin e procedurave për përfundimin e hetimit.

2. Gjatë veprimeve përgatitore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka konstatuar se kërkesa kishte disa të meta procedurale: (i) taksa gjyqësore në shumën 200 lekë nuk ishte paguar; (ii) kërkesa ishte paraqitur vetëm në një kopje; (iii) kallëzimi penal, që duhet të provonte depozitimin e tij, ishte paraqitur vetëm me nënshkrimin e kërkuesit, pa numër protokolli; (iv) nuk ishin paraqitur akte të tjera provuese në aq kopje sa ishin palët e thirrura në gjykim; (v) nuk ishin paraqitur gjeneralitetet e personave të tretë, si dhe adresat e sakta të tyre. Me konstatimin e këtyre të metave dhe bazuar në nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ajo gjykatë, me vendimin nr. 3228, datë 10.04.2018, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes kërkuesit, me arsyetimin se të metat ishin thelbësore për shqyrtimin e çështjes.

3. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 566/30-2024-3386, datë 07.05.2024. Kërkuesi ka paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi, të cilin e ka paraqitur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin e datës 01.10.2024, i ka caktuar kërkuesit afat për të plotësuar disa të meta në rekursin e paraqitur, që kishin të bënin me mungesën e nënshkrimit të avokatit, të prokurës së posaçme për avokatin dhe të vendimit të kundërshtuar. Në kushtet kur të metat nuk janë plotësuar nga kërkuesi brenda afatit, ajo gjykatë, me vendimin e datës 23.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Mbi bazën e rekursit të veçantë të kërkuarit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-578, datë 12.02.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimit, duke vendosur kthimin e rekursit.

5. Në datën 03.06.2025 kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.1. *E drejta e aksesit në gjykatë* e lidhur me *parimin e sigurisë juridike*, për shkak se kërkesa për ta nënshkruar rekursin me avokat i ka refuzuar në thelb të drejtën që çështja e tij të dëgjohej nga gjykata, për më tepër kur vetë kërkuari është i pajisur me licencë avokati.

6.2. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procesi gjyqësor i zhvilluar në gjykatat e zakonshme ka zgjatur rreth 7 vjet, duke tejkaluar haptazi afatet e shpejta të përcaktuara nga neni 399/7 i KPC-së; zbardhja e vendimeve gjyqësore nga të tria shkallët e gjyqësorit është bërë tej afateve të parashikuara nga neni 308 i KPC-së; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur afatet e parashikuara nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale.

6.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit, në vendimmarrjen e datës 23.10.2024, ka gabuar bazën ligjore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative

të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ, si subjekt i kushtëzuar, duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se ai duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 65, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket aspektit substancial, individ mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se, në thelb, kërkuuesi pretendon konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të çështjes penale (konkretisht të fazës së hetimit paraprak të saj) të vënë në lëvizje bazuar në kallëzimin e paraqitur nga ai për veprat penale në ngarkim të një gjyqtari dhe një prokurori. Sipas kërkuesis, ndonëse ai është ankuar në gjykatat e zakonshme për cenimin e kësaj të drejte kushtetuese, ato gjykata kanë tejkaluar haptazi afatet ligjore të shqyrtimit të çështjes dhe të arsyetimit të vendimeve, madje i kanë refuzuar pa shkak ligjor edhe rekursin e paraqitur, duke i mohuar të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

10. Në lidhje me këtë kriter, me vendimin e ndërmjetëm të datës 16.07.2025, Kolegji ka vendosur kthimin e akteve kërkuesis, duke i kërkuar atij paraqitjen e kallëzimit penal, si dhe argumentet me të cilat ai justifikon interesin e tij për procedimin penal. Në përgjigjen e tij të datës 21.08.2025 kërkuuesi ka parashtruar se ishte viktimë reale e veprës penale dhe se kërkonte përfundimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke paraqitur kallëzimin penal të nënshkruar nga vetë ai, por pa e shoqëruar me ndonjë akt që tregonte se kallëzimi ishte dorëzuar në prokurori.

11. Në këto rrethana, Kolegji vëren se kërkuuesi nuk ka arritur të provojë që ka paraqitur kallëzim penal në prokurori, megjithëse iu la koha e nevojshme në dispozicion, fakt ky që është pohuar edhe nga gjykatat e zakonshme në vendimet e kundërshtuara. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë është shprehur se pranë saj është depozituar një kallëzim penal i nënshkruar nga kërkuuesi, por pa ndonjë numër protokolli që të provojë faktin se kallëzimi është depozituar dhe regjistruar si i tillë në organin e ndjekjes penale, ndërsa gjykata e apelit është shprehur se

nga ana e kërkesit nuk është depozituar asnjë akt, siç mund të jetë vërtetimi i sekretarisë së atij organi, që të tregojë se ai ka depozituar një kallëzim të tillë.

12. Për sa më lart, Kolegji çmon se, në rastin konkret, kërkesi nuk justifikon interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar, ndaj nuk legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

13. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.